

STATISTIKAT E ARSIMIT - STATISTIKA TË REGJISTRIMEVE NË ARSIM

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
5.1 Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidentialiteti	6
8. Politika e botimit.....	6
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koheranca dhe Krahasueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave.....	11
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Analizave Ndërsektoriale, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale.
1.3. Personi i kontaktit	Elda Muça
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Analizave Ndërsektoriale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	emuca@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	08.08.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	08.08.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	08.08.2025
3. Paraqitura statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Regjistrimet në arsim</p> <p>INSTAT organizon punën për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi regjistrimet e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në arsimin zyrtar, bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Ligjin e Statistikës. Mbi bazën e informacionit të mbledhur kryhet llogaritja e treguesve dhe publikimi i statistikave të regjistimeve. Informacioni mblidhet nga çdo njësi që ofron shërbimin arsimor publik ose privat në vend si kopshte, shkolla, universitete, kolegje etj. Informacioni i mbledhur për arsimin parauniversitar kalon nga njësítë bazë në drejtoretë dhe zyrat arsimore dhe nëpërmjet tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, (për arsimin profesional dhe pas të mesëm jo të lartë). Këto dy Ministri i përcjellin INSTAT në formën e tabelave të përbledhura në excel të</p>

	<p>gjithë informacionin e grumbulluar. Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore. Të dhënat për regjistimet e arsimit të lartë mblidhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit direkt nga shkollat e larta, universitetet ose kolegjet dhe po ashtu në formën e tabelave të përbledhura në excel, që i vihen në dispozicion INSTAT-it.</p> <p>Stafi mësimdhënës</p> <p>Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit lidhur me nxënësit ose studentët.</p> <p>Institucionet arsimore</p> <p>Informacioni mblidhet dhe përpunohet sipas niveleve arsimore dhe llogariten treguesit sipas institucioneve arsimore etj.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Statistikat e arsimit përpunohen dhe publikohen sipas klasifikimit <u>ISCED-2011</u>.</p> <p>Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> Niveli 0 - Arsimi parashkollar – çerdhe/kopshte; Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë; Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë; Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor; Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë; Niveli 5 – Arsimi i lartë cikël i shkurtër Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent; Niveli 7 - Master ose ekuivalent; Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent. <p>Klasifikimi i fushave të studimit për arsimin e lartë bëhet në bazë të <u>ISCED-F 2013</u>, ku grupimet kryesore janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Shkenca arsimi; 2- Arte dhe Shkenca humane; 3- Shkenca sociale, Gazetari dhe Informacion; 4- Biznes, Administrim dhe Ligj; 5- Shkenca natyrore, Matematikë dhe Statistikë; 6- Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit;

	<p>7- Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim;</p> <p>8- Bujqësi, Pyje, Peshkim dhe Veterinari;</p> <p>9- Shëndet dhe mirëqenie;</p> <p>10- Shërbime.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Arsimi paraqitet në katër aktivitetet kryesore të tij: regjistrime dhe diplomime të nxënësve dhe studentëve përkatësisht në arsimin parauniversitar dhe atë universitar, institucionet e përfshira në arsim si dhe stafin mësimdhënës.</p>
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	<p>Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.</p> <p>Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.</p> <p>Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.</p> <p>Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin, arsimin social-kulturor dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë.</p> <p>Mësues janë përcaktuar personat, aktiviteti profesional i të cilëve, përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor tek nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.</p> <p>Institucion arsimor publik klasifikohet si i tillë nëse aktiviteti i tij kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.</p> <p>Raporti i regjistrimit bruto – GER, është numri i të regjistruarve në një nivel të caktuar të arsimit, pavarësisht nga mosha, e shprehur si përqindje e popullsisë zyrtare në moshë shkolllore, që korrespondon me të njëtin nivel të arsimit.</p> <p>Raporti i regjistrimit neto – NER, është numri i përgjithshëm i nxënësve në grupmoshën teorike për një nivel të caktuar të arsimit të regjistruar në atë nivel, i shprehur si përqindje e popullsisë në atë grupmoshë.</p>

	<p>Raporti nxënës pér mësues është raporti i numrit të nxënësve të regjistruar në një nivel të caktuar të arsimit me numrin e mësuesve në të njëtin nivel.</p> <p>Indeksi i barazisë gjinore shpreh reportin e GER pér femrat kundrejt meshkujve. Nje indeks barazie gjinore i barabartë me 1 tregon barazinë midis femrave dhe meshkujve. Në përgjithësi, një vlerë më pak se 1 tregon një pabarazi në favor të djemve dhe një vlerë më e madhe se 1 tregon një pabarazi në favor të vajzave.</p> <p>Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të dizenjuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathësitë dhe kompetencat specifike pér një profesion të veçantë, klasë të profesioneve ose zanat.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore janë fëmijë, nxënës, studentë, mësues- staf mësimdhënës, etj.
3.6. Popullata statistikore	Fëmijë, nxënës dhe studentë të regjistruar në arsimin zyrtar publik dhe privat, sipas gjinisë, moshës, programeve dhe niveleve arsimore, staf mësimdhënës (edukatore, mësues dhe pedagogë).
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e përbledhura janë në nivel qarku dhe vendi.
3.8. Mbulimi në kohë	Shumica e të dhënavëve janë të disponueshme që nga viti 1990.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Regjistrimi i fëmijëve, nxënësve ose studentëve në arsim, rapporti bruto i regjistrimit sipas niveleve arsimore (kopësht, arsim fillor, arsim i mesëm i ulët, arsim i mesëm i lartë, arsim pas të mesmes jo i lartë, arsim i lartë, rapporti neto i regjistrimit sipas niveleve arsimore, rapporti i nxënësve pér një mësues, etj.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Ky report i referohet vitit shkollor 2024-2025.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Në nivel kombëtar, Statistikat e arsimit janë bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare pér periudhën 2022-2026; • Memorandum me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
6.2. Shkëmbimi i të dhënavë	INSTAT transmeton rregullisht në UNESCO-UIS të dhëna të detajuara mbi arsimin parauniversitar dhe atë universitar, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të

	hartuar paraprakisht nga ky institucion ndërkombëtar. Të dhënrat mbulojnë arsimin parauniversitar dhe atë universitar dhe jepen të detajuara sipas çdo programi, publik/privat, gjinisë, moshave etj.
--	---

7. Konfidencialiteti

7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënrat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënavë Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabelë përbledhëse të tillë që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njojur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënavë kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënavë, të dhënrat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektit të mos jenë më të identifikueshmë.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënavë	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënrat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënrat në fjalë për arsy e dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënrat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i Statistikave vetëm në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënavë. <p>Të dhënrat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesi tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënrat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksosit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>

8. Politika e botimit

8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpëndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet
------------------------------	--

	data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesi në kalendarin e publikimeve	<u>Kalendari</u> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesi i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahan në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Website</u> – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimet e Regjistrimeve; 4. <u>Kërkesa për të dhëna</u>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Shpërndarja e të dhënavë të arsimit bëhet në baza vjetore.
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp mbi regjistrimet përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të regjistrimeve të arsimit si p.sh. Pjesëmarrja bruto dhe neto e nxënësve dhe studentëve në vitin shkollor/akademik, raportin nxënës për një mësues, regjistrimet sipas niveleve arsimore, etj.</p> <p>Njoftimi për shtyp “<u>Statistika të Regjistrimeve në Arsim</u>” publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet mbi Statistikat e Arsimit në faqen e internetit të INSTAT të organzuara si më poshtë:</p> <p>Vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Burrat dhe Gratë në Shqipëri</u>; • <u>Shqipëria në shifra</u>; • <u>Vjetari statistikor</u>; • <u>Vjetari Rajonal Statistikor</u>. <p>Botim i dedikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Statistika të Regjistrimeve në Arsim</u>.
10.3. Baza e të dhënavë on-line	Të dhënat mbi statistikat e arsimit publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin <u>Databaza</u> .

10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e arsimit nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e rruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënavë që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet këtij seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative në vend si Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe ajo e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Një shpjegim i shkurtër rrëth përkufizimeve dhe Metodologjisë për statistikat e arsimit, i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si edhe në Press Release-in e Regjistrimeve në Arsim.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Të gjitha punët rrëth statistikave të arsimit janë të dokumentuara sipas proceseve dhe procedurave të punës.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standarde shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vleftezimi i të dhënavë janë veprime që kryen përgjatë tërë procesit. Stafi i përfshirë në fazën e ndryshme të përpilimit të të dhënavë është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Burimi i të dhënavë për Statistikat e Arsimit është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e statistikave të arsimit klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm. • Përdoruesit e jashtëm janë:

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Institucionet e Administratës Publike; ○ Universitetet; ○ Bizneset; ○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; ○ Organizata kombëtare jofitimprurëse; ○ Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat me pyetësorin përkatës; ○ Informacion shumë i detajuar dërgohet në UNESCO-UIS, Eurostat etj. <ul style="list-style-type: none"> ● Përdoruesit e brendshëm janë sektorët brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat e Arsimit si input për punën e tyre. <p>Qëllimi kryesor i prodhimit të Statistikave të Arsimit është sigurimi i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për nevojat e publikut lidhur me to.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e <u>Kënaqësia e përdoruesve</u>.</p> <p>Rezultatet e vrojimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Statistikat e Arsimit" është vlerësuar me 3.82 pikë (76.4 %) nga një shkalle prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënavë për "Statistika të Regjistrimeve në Arsim" për vitin akademik 2024-2025 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026).</p> <p>Shkalla e Plotshmërisë për "Statistika të Regjistrimeve në Arsim", për vitin 2024-2025 rezulton të jetë 97%. Të dhënat e publikuara mbi statistikat e regjistrimeve në arsimin e lartë, programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2024-25 janë paraprake dhe subjekt rishikimi.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Informacioni mbi "Statistikat e Regjistrimeve në Arsim" grumbullohet nga burimet administrative dhe të dhënat janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● <u>Politika e Revisionimit Statistikor</u>.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për përditësimet e mundshme në raportimin e të dhënavë nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënavë ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime

	dhe do të jepet një informacion i shkurtër sëqarues për përdoruesit. Gabimet e jo kampionimit trajtohen bazuar në politikën e trajtimit të gabimeve.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet në lidhje me “Statistika të Regjistrimeve në Arsim” publikohen në faqen e internetit të INSTAT 143 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (Y+143 ditë). Periudha referuese e rezultateve “Statistika të Regjistrimeve në Arsim” është 31 Dhjetor 2024.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>5/23/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>143</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e publikimit	5/23/2025	Afatet kohore	143		
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e publikimit	5/23/2025								
Afatet kohore	143								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënrat për “Statistika të Regjistrimeve në Arsim” publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave të “Statistika të Regjistrimeve në Arsim” për vitin akademik 2024-2025 është shtyrë në kohë me 77 ditë si pasojë e kryerjes së disa verifikimeve të të dhënave me institucionet burim të të dhënave.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>5/23/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>8/08/2025</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>77</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e shpallur	5/23/2025	Data e publikimit	8/08/2025	Vonesa në kohë	77
Periudha referuese	12/31/2024								
Data e shpallur	5/23/2025								
Data e publikimit	8/08/2025								
Vonesa në kohë	77								
15. Koheranca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjografike	<p>Statistikat e Arsimit paraqiten në nivel prefekturë dhe vendi. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënata koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.</p> <p>Gjithashtu në nivel ndërkombëtar sigurohet krahasueshmëria e tyre e cila bëhet e mundur me dërgimin e të dhënave dhe statistikave të arsimit në institucionë ndërkombëtare dhe evropiane. Kushti kryesor që siguron krahasueshmërinë është përdorimi i klasifikimit ndërkombëtar ISCED-2011 në Statistikat e Arsimit në Shqipëri.</p>								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat e Arsimit datojnë që nga viti 1991 referuar databazës statistikore.</p> <p>Nga viti 2004, të dhënata e Arsimit Parauniversitar sigurohen sipas një formati të caktuar elektronik të përcaktuar nga burimi administrativ dhe INSTAT, duke siguruar një krahasueshmëri në seri kohore prej 21 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=21).</p>								
15.3. Koheranca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.								
15.4. Koheranca e brendshme	Konsistenza e brendshme e të dhënave kontrollohet para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablate dhe koheranca në seri të ndryshme.								

16. Kostoja dhe ngarkesa

16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Arsimit pranë sektorit të Analizave Ndërsektoriale, në Drejtorinë Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale është: 1 punonjës.
---------------------------	--

17. Rishikimi i të dhënave

17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Statistikave të Arsimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: <ul style="list-style-type: none">• <u>Politika e Revizionimit</u>;• <u>Politika e Trajtimit të Gabimeve</u>.
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast ndryshimesh në pyetësorët që dërgohen në UNESCO për Statistikat e Arsimit, INSTAT bën rishikime në të dhënat dhe ridërgon pyetësorët me ndryshimet dhe shpjegimet përkatëse. Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Regjistimeve në Arsim” për vitin 2024-2025, subjekt i këtij raporti.

18. Përpunimi statistikor

18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi “Statistikat e Regjistimeve në Arsim” bazohen në burime administrative. Ofruesit kryesorë të të dhënave të arsimit janë: Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mbi “Statistika e Regjistimeve në Arsim” mblidhen në bazë vjetore me fillimin e shkollës ose vitit akademik.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e treguesve dhe Statistikave të Arsimit, i orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Arsimit dhe Sportit është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha nivelet e arsimit zyrtar që kryhet në vend sipas këtij programi. Po ashtu Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është burimi i të dhënave për arsimin profesional dhe arsimin pas të mesëm jo të lartë. Programi përmban një sistem pasqyrash, që plotësohen me të dhëna sasiore nga të gjitha institucionet arsimore, të mbledhura në mënyrë periodike, në bazë të një metodologjje të caktuar. Në mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave të Arsimit shqiptar përdoret Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit ISCED, aplikuar fillimisht varianti i vitit 1997, dhe që nga viti 2013 ISCED-2011, sipas rekomandimeve edhe të Eurostat dhe UNESCO-s.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrollet logjike dhe matematikore aplikohen në të dhënat administrative të arsimit. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistенca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet

	përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Mbulimi është gjithë përfshirës në nivel vendi dhe prefekture, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet përherë në kohë, prandaj vlerësimi i të dhënave nuk është i nevojshëm.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	